

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 04.03.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2014, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 62 të datës 31.01.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuar dhe miratuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049 (Gazeta Zyrtare 27/2008), nenin 27, shkronja (c, ç), nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Lejohet bartja e të hyrave vetiake nga vitit 2013, në vitin 2014 në shumë të përgjithshme prej 522,755.50€, nga fondi burimor 21 dhe 22 sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2013.
2. Ridestnimi i të hyrave vetiake nga fondi burimor 21 dhe 22 lejohet si vijon:

Fondi	Organizata	Kodi	Programi	Kategoria	Përshkrimi Kategoria	Kodi i	Shuma në	Shuma për
Burimor	Buxhetore	Prog		Ekonomike	Ekonomike	Projektit	2013	2014
21	612	16002	Zyra e Kryetarit të Komunës	130	Mallra dhe Shërbime		5,000.00	5,000.00
21	612	16302	Administratë	130	Mallra dhe Shërbime		5,000.00	5,006.11
21	612	16603	Inspekcioni	130	Mallra dhe Shërbime		5,000.00	5,000.00
21	612	17502	Buxhet	130	Mallra dhe Shërbime		10,000.00	10,000.16
21	612	17502	Buxhet	200	Subvencione dhe Transfere		719.84	719.84
21	612	17502	Buxhet	300	Blerja e Kompjuterëve	87144	177.36	
21	612	17502	Buxhet	300	Blerja e Mobiljeve	87145	4,548.00	4,725.36
21	612	17502	Buxhet	300	Blerja e Automjeteve	87146	5,000.00	5,000.00
21	612	17502	Buxhet	300	Blerja e Fotokopjeve	87147	5,000.00	5,000.00
21	612	17502	Buxhet	300	Bashkfinancim i Projekteve	87148	30,000.00	34,087.98
21	612	18162	Inf.Publike	130	Mallra dhe Shërbime		61,605.95	61,605.95
21	612	18162	Inf.Publike	132	Komunali		16,477.05	16,477.05
21	612	18162	Inf.Publike	200	Subvencione dhe Transfere		0.01	0.01
21	612	18162	Inf.Publike	300	Mir Inf.Rrugore Kanlizimit	87150	280.00	
21	612	18162	Inf.Publike	300	Blerja e Kontinjerëve	87151	29.50	
21	612	18162	Inf.Publike	300	Pastrimi i Ambientit	87152	138.48	2,959.17
21	612	18162	Inf.Publike	300	Ndër Parqeve Trotuarëve	87153	995.22	

21	612	18162	Inf.Publike	300	Rastet Emërgjente	87154	945.01	
21	612	18162	Inf.Publike	300	Vend.Ndriqimit dhe Mirmb Nder.sis.Ujësjetlësit	87155	0.76	
21	612	18162	Inf.Publike	300	sis.Ujitjes	87156	20.00	
21	612	18162	Inf.Publike	300	Shtuarja e rrugëve terciare	87157	550.20	
21	612	18162	Inf.Publike	300	Nder.Trotuarit fsh.Sllatinë	87158	10,000.00	10,000.00
21	612	47042	Bujqësi	130	Mallra dhe Shërbime		5,000.00	5,000.00
21	612	47042	Bujqësi	300	Pyllëzimi i sip të Zhveshura	87159	50.00	
21	612	47042	Bujqësi	300	Pastrimi Sanitar i Pyjeve	87160	38.00	
21	612	66015	Urbanizëm	130	Mallra dhe Shërbime		5,000.00	5,859.25
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në Fushë Kosovë	87162	8,424.65	8,424.65
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi Bardh i Vogël	87165	765.75	
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi Sllatinë e Madhe	87166	5,940.00	5,940.00
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi Vragoli	87167	6,780.00	6,780.00
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi Miradi e Epërme	87168	1,393.00	1,393.00
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi Harilaq	87170	2,010.00	2,010.00
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi Lismir	87171	3,527.00	3,527.00
21	612	66015	Urbanizëm	300	Nder.Kanaliz.Ujësjetlësit	87173	5.50	
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi Mesbardh-Kuzmin	87174	20,000.00	20,000.00
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi Henc	87175	1,463.00	1,463.00
21	612	73011	Admi.Shëndetësi	130	Mallra dhe Shërbime		10,000.00	10,000.00
21	612	73011	Admi.Shëndetësi	200	Subvencione dhe Transfere Blerja e paisjeve për Shëndetësi		21,099.00	21,758.25
21	612	73011	Admi.Shëndetësi	300		87176	14.00	
21	612	73011	Admi.Shëndetësi	300	Mir.Objekteve Shendetesore	87177	12.00	
21	612	73011	Admi.Shëndetësi	300	Nder.Shtëpive raste Sociale	87178	92,129.75	96,406.49
21	612	73011	Admi.Shëndetësi	300	Rregullimi oborreve të ambulantave	87179	25,000.00	25,000.00
21	612	73011	Admi.Shëndetësi	300	D.D.D	87180	633.25	
21	612	73150	Kujdesi Primar	111	Paga dhe Rroga		15,000.00	15,000.00
21	612	85002	K.R.S	130	Mallra dhe Shërbime		5,000.00	5,000.00
21	612	85002	K.R.S	200	Subvencione dhe Transfere		10,000.00	10,057.46
21	612	85002	K.R.S	300	Gjurmime Arkeologjike	87182	10,767.00	10,767.00
21	612	85002	K.R.S	300	Nder.Palestrave Sportive	87183	45,000.00	45,000.00
21	612	85002	K.R.S	300	Fusha të Sportit	87184	7.00	
21	612	92010	Admi.Arsim	130	Mallra dhe Shërbime		10,000.00	10,001.21
21	612	92010	Admi.Arsim	200	Subvencione dhe Transfere		48.46	
21	612	92010	Admi.Arsim	300	Blerja e Inventarit	87186	2.00	
22	612	16302	Administratë	130	Mallra dhe Shërbime		6.11	
22	612	17502	Buxhet	300	Bashkfinancim i Projekteve	85083	4,087.98	
22	612	17502	Buxhet	130	Mallra dhe Shërbime		0.16	
22	612	47042	Bujqesi	200	Subvencione dhe Transfere Hartimi Planit		2.99	2.99
22	612	66015	Urbanizëm	300	Zhvill.Komunal	82094	136.26	
22	612	66015	Urbanizëm	300	Rrërimi Objek të vjetra Banesore	84018	870.82	
22	612	66015	Urbanizëm	300	Shpronësimi i Tokave	84019	5,424.00	5,424.00
22	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në Lismir	85107	732.50	
22	612	66015	Urbanizëm	300	Pastrimi i lumit Drenica	85111	5,505.00	7,244.58

22	612	73011	Admi.Shëndetësi	300	Ndërtimi i shtëpive Raste Sociale	85118	4,276.74	
22	612	92010	Admi.Arsim	130	Mallra dhe Shërbime		1.21	
22	612	92010	Admi.Arsim	300	Rrethoja e shkollës në B.Vogël	84020	10,114.99	10,114.99
22	612	92010	Admi.Arsim	300	Shkolla në Nakaradë	85130	25,000.00	25,000.00


522,755.50€ 522,755.50€

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**



Më datë: 04.03.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2014, bazuar në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 9 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62 të datës 16.05.2013 miraton:

**PLANIN VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS, KOMITETIT PËR POLITIKË
DHE FINANCA DHE KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2014**

1. Plan i Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete përfshinë punën dhe aktivitetet e parapara për vitin 2014.
2. Realizueshmëria e Planit Vjetor të Punës për vitin 2014 është:
 - 2.1 Më datën 24 Janar 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:
 - 2.1.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.1.2 Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa;
 - 2.1.3 Themelimi i Komitetit për Komunitete;
 - 2.1.4 Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2014;
 - 2.1.5 Caktimi i lokacionit për ndërtimin e 'Tregut të Gjellbër në Fushë-Kosovë';
 - 2.1.6 Të ndryshme.
 - 2.2 Me datën 28 Shkurt 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:
 - 2.2.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.2.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
 - 2.2.3 Miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete për vitin 2014;

- 2.2.4 Informatë për Planin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2014;
- 2.2.5 Shqyrtimi i propozimit për bartjen dhe shpërndarjen e të hyrave vetiake të vitit 2013, në vitin 2014;
- 2.2.6 Shqyrtimi i propozimit për ndarjen e subvencioneve në Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
- 2.2.7 Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës;
- 2.2.8 Shqyrtimi i propozimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- 2.2.9 Shqyrtimi i propozimit për fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të Ngastrës Kadastrale Nr.1342 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 2.2.10 Caktimi i anëtarëve nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës për përfaqësim në Asociacionin e Komunave të Republikës së Kosovës;
- 2.2.11 Plotësimi i Komitetit për Komunitete me anëtarin e komunitetit malazez.

2.3 Me datën 27 Mars 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

- 2.3.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.3.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
- 2.3.3 Raporti përfundimtar Vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2013;
- 2.3.4 Shqyrtimi i Raportit përfundimtar vjetor financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2013;
- 2.3.5 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës, Kuvendi i Komunës, grupet e interesit, shoqëria civile dhe qytetarët;
- 2.3.6 Informatë e Drejtorisë për Administratë për Rregulloret në fuqi dhe ato të miratuara në mandatin zgjedhor 2009/2013;
- 2.3.7 Informatë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për aktivitetet e saj;
- 2.3.8 Raportimi i Drejtorive të Komunës për Rregulloret që duhet të hartohen dhe ndryshohen në periudhën Mars/Dhjetor.

2.4 Me datën 24 Prill 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

- 2.4.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.4.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
- 2.4.3 Shqyrtimi i Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë të vitit 2014;
- 2.4.4 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
- 2.4.5 Informatë e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, për pronën e paluajtshme komunale dhe shqyrtimi i mundësive të dhënies së saj me qira;
- 2.4.6 Informatë e shkurtër e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për punën e Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës në tremujorin e parë;
- 2.4.7 Informatë e shkurtër e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete për punën në tremujorin e parë, mbështetur në aspektet ligjore të obligimeve të tij.

2.5 Me datën 22 Maj 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

- 2.5.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.5.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
- 2.5.3 Shqyrtimi dhe miratimi i 'Planit dinamik për organizimin e Dëgjimeve Publike për buxhetin e vitit 2015';
- 2.5.4 Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të buxhetit për vitin 2014;
- 2.5.5 Shqyrtimi i propozimeve për shpalljen e 'Qytetar Nderi', për vitin 2014;
- 2.5.6 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
- 2.5.7 Informatë e Drejtorisë për Arsim për rrjedhën e vitit shkollor 2013/2014 dhe përgatitjet e nxënësve për testet e semimaturës dhe maturës shtetërore;
- 2.5.8 Informatë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për punët tekniko-formale dhe shëndetësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, si dhe punëve dhe aktiviteteve në Qendrën për Punë Sociale;

2.6 Me datën 19 Qershor 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

- 2.6.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.6.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
- 2.6.3 Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2015-2017;
- 2.6.4 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
- 2.6.5 Informatë e Drejtorisë së Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planeve Urbane dhe urbano-periferike-rurale;
- 2.6.7 Informatë e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis për punën dhe hapat e paraparë për punë dhe intervenime në terren gjatë stinës verore;
- 2.6.8 Informatë e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim Rural për zbatimin e programit për zhvillimin e agrobiznesit.

2.7 Me datën 17 Korrik 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

- 2.7.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.7.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
- 2.7.3 Raportimi i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës;
- 2.7.4 Shqyrtimi i Raportit financiar për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e dytë të vitit 2014;
- 2.7.5 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
- 2.7.6 Informatë e Drejtorisë për Inspektorat për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për inspektim;

- 2.7.7 Informatë e shkurtër e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për zbatimin e planit vjetor të punës në gjashtëmujorin e parë;
- 2.7.8 Informatë e shkurtër e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete për punën në gjashtëmujorin e parë, mbështetur në aspektet ligjore të obligimeve të tij.

2.8 Me datën 11 Shtator 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

- 2.8.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.8.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
- 2.8.3 Konfirmimi për vazhdimin e zbatimit të Rregullores Komunale për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në vitin 2015;
- 2.8.4 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
- 2.8.5 Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2014/2015.

2.9 Me datën 25 Shtator 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

- 2.9.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.9.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
- 2.9.3 Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të Komunës për vitin 2015;
- 2.9.4 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës.

2.10 Me datën 23 Tetor 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

- 2.10.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.10.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
- 2.10.3 Shqyrtimi i Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e tretë të vitit 2014;
- 2.10.4 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës.

2.11 Me datën 20 Nëntor 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

- 2.11.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.11.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;
- 2.11.3 Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor për punën e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2015;
- 2.11.4 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës.

2.12 Me datën 18 Dhjetor 2014 Kuvendi i Komunës shqyrton:

2.12.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.12.2 Pyetje parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës;

2.12.3 Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor për punën e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2015;

2.12.4 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës.

3. Politikat programore, projekt-rregulloret, propozim-vendimet, planet investive, planet dhe dokumentet strategjike, raportet financiare tremujore dhe vjetore, shqyrtohen paraprakisht në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete. Planit Vjetor i Prokurimit dhe Planit Vjetor për Auditim të Brendshëm, shqyrtohen në muajin Mars 2014 në Komitetin për Politikë dhe Financa.

4. Dinamika e kohës dhe orarit të përgatitjes së mbledhjeve të rregullta të Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2014 është si në vijim:

4.1 Për muajin Janar 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 15.01.2014, mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 24.01.2014 ora 10:00h;

4.2 Për muajin Shkurt 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 12.02.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 20.02.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 20.02.2014 ora 13:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 28.02.2014 ora 10:00h;

4.3 Për muajin Mars 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 06.03.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 17.03.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 18.03.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 27.03.2014 ora 10:00h;

4.4 Për muajin Prill 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 03.04.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 14.04.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 15.04.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 24.04.2014 ora 10:00h;

4.5 Për muajin Maj 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 02.05.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 12.05.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 13.05.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 22.05.2014 ora 10:00h;

4.6 Për muajin Qershor 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 30.05.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 09.06.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 10.06.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 19.06.2014 ora 10:00h;

4.7 Për muajin Korrik 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 27.06.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 07.07.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 08.07.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 17.07.2014 ora 10:00h;

- 4.8 Për muajin Shtator 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 22.08.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 01.09.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 02.09.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 11.09.2014 ora 10:00h;
- 4.9 Për muajin Shtator 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 05.09.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 15.09.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 16.09.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 25.09.2014 ora 10:00h;
- 4.10 Për muajin Tetor 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 03.10.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 13.10.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 14.10.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 23.10.2014 ora 10:00h;
- 4.11 Për muajin Nëntor 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 31.10.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 10.11.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 11.11.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 20.11.2014 ora 10:00h;
- 4.12 Për muajin Dhjetor 2014, dorëzimi i pikave nga Ekzekutivi i Komunës deri më datën 27.11.2014, mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 08.12.2014 ora 10:00h, mbledhja e Komitetit për Komunitete më datën 09.12.2014 ora 10:00h dhe mbledhja e Kuvendit të Komunës më datën 18.12.2014 ora 10:00h;
5. Për zbatimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2014, kompetentë është Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.
6. Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014, hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive Komunale dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.03.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2014, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 73, të datës 06.02.2014, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 36 paragrafi 1, 3, 4, 5, 6 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF-Shpenzimi i Parave Publike, Udhëzimin Administrativ 2005/08 për Klasifikimin Ekonomik të Shpenzimeve, nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 1, nenin 3, nenin 6 dhe nenin 11 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:


V E N D I M

1. Për rishpërndarjen e subvencioneve në shumë të përgjithshme prej 300,000.00€, të planifikuara me buxhetin komunal, të aprovuar për vitin 2014.
2. Me mjetet financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, subvencionohen bizneset e reja që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e punësimit, fermerët dhe familjet në fushën e bujqësisë, blegtorisë, shpeztarisë dhe bletarisë me:
 - 2.1 Ngritjen e serrave në shumë prej 50,000.00€;
 - 2.2 Ndarjen e gjedhave në shumë prej 70,000.00€;
 - 2.3 Ndarjen e plantacioneve për ngritjen e pemishteve në shumë prej 20,000.00€;
 - 2.4 Ndarjen e mekanizmit bujqësorë në shumë prej 30,000.00€;
 - 2.5 Ndarjen e folive plastike në shumë prej 6,000.00€;
 - 2.6 Ndarjen e pulave në shumë prej 20,000.00€;
 - 2.7 Ndarjen e bletëve në shumë prej 10,000.00€;
 - 2.8 Vaksinimin e kafshëve dhe shpezëve në shumë prej 10,000.00€;
 - 2.9 Ndarjen e makinave mjelëse në shumë prej 10,000.00€;
 - 2.10 Bizneset e reja në shumë prej 30,000.00€;
 - 2.11 Participimi me donatorë në shumë prej 44,000.00€.
3. Është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim Rural, të caktoj Komisionin Profesional për përzgjedhjen e përfituesëve të subvencioneve, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, kushtet dhe kriteret e caktuara për aplikuesit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për FBP, Drejtorisë për EZHR dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 06.03.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2014, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 81, të datës 10.02.2014, bazuar në nenin 7 të Ligjit për Policinë Nr. 04/L-076 (Gazeta Zyrtare Nr. 04/2012), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 3, nenin 4, nenin 9, nenin 14 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2013/2017.
2. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi përbëhet prej 19 anëtarëve:
 - 2.1 Burim Berisha - Kryetar i Komunës, Kryesues i KKSB-së;
 - 2.2 Vjollca Hoti - Komandante e Stacionit Policor në Fushë-Kosovë, anëtar;
 - 2.3 Nexhat Tërnavë - Përfaqësues i Bashkësisë Islame, anëtar;
 - 2.4 Nikola Dragičević - Përfaqësues i Kishës Ortodokse, anëtar;
 - 2.5 Sasha Stamenković - Përfaqësues i Komunitetit Serb, anëtar;
 - 2.6 Tomislav Daniç - Përfaqësues i Komunitetit Malazez, anëtar;
 - 2.7 Fehmi Gashi - Përfaqësues i Komunitetit Rom, anëtar;
 - 2.8 Qerim Gara - Përfaqësues i Komunitetit Ashkali, anëtar;
 - 2.9 Fatmir Durmishi - Përfaqësues i Komunitetit Egjiptian, anëtar;
 - 2.10 Lindita Dervisholli/ Prebreza - Zyrtare për Barazi Gjinore, anëtar;
 - 2.11 Islam Shabani - Drejtor për Arsim, anëtar;
 - 2.12 Gëzim Sopi - Përfaqësues i Forcës së Sigurisë, anëtar;
 - 2.13 Ejup Qyqalla - Përfaqësues i KLSP-së, anëtar;
 - 2.14 Ali Topalli - Përfaqësues i EVSB-së, anëtar;
 - 2.15 Maliq Berisha - Përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale, anëtar;
 - 2.16 Sllagjana Laziç - Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
 - 2.17 Maliq Thaçi - Përfaqësues i OJQ-ve, anëtar.
3. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi plotësohet me anëtarin në pozitën e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete pas zgjedhjes dhe me anëtarin në cilësinë


e përfaqësuesit të Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Fushë-Kosovës pas zgjedhjes.

4. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është përgjegjës për kryerjen e detyrave dhe punëve të caktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe për punën e tij e informon Kuvendin e Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për FBP, Anëtarëve të KKSB-së dhe Arkivës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krashiqi**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.03.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2014, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 43 të datës 11.02.2014, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 3, paragrafi 1, pika 1.3, nenin 4, nenin 5, nenin 7 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale Nr. 04/L-144, (Gazeta Zyrtare Nr. 35/2012), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 mori:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim propozimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me qira të Ngastres Kadastrale Nr. P-72514036-01342-0, në sipërfaqe prej 1959m², të evidentuar në Certifikatën e Pronës Nr. 25-1338 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë.
2. Është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, që për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me qira të kësaj proneje, të identifikojnë vlerën e pronës, arsyeshmërinë ekonomike dhe të caktojnë kohëzgjatjen e dhënies së pronës në shfrytëzim, brenda periudhës së caktuar në nenin 3, paragrafi 1, pika 1.3, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale Nr. 04/L-144 dhe interesit publik të komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për PUKGJ dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.03.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2014, pas shqyrtimit të kërkesës së Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për caktimin e anëtarëve nga Komuna e Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2013/2017, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:


V E N D I M

1. Për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2013/2017.
2. Komunën e Fushë-Kosovës në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës do ta përfaqësojnë;
 - 2.1 Burim Berisha - Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës;
 - 2.2 Mirishahe Berisha - Anëtare e Kuvendit të Komunës;
 - 2.3 Migjen Kolshi - Anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 2.4 Miroslav Veličković - Anëtar i Kuvendit të Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për Administratë, Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.03.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2014, bazuar në nenin 51, paragrafi 51.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (b) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për plotësimin e Vendimit, me Nr. të protokollit 08, të datës 29.01.2014, për themelimin e Komitetit për Komunitete.
2. Pika një e Vendimit, me Nr. të protokollit 08, të datës 29.01.2014, plotësohet me anëtarin Tomislav Daniç - Përfaqësues i Komitetit Malazez.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës dhe është pjesë e Vendimit me Nr. të protokollit 08 të datës 29.01.2014.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për FBP, Anëtarit të Komitetit për Komunitete dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi

